



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|------------|------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI - | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI - | Anëtare |
| Rezarta | BITRI - | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Prefekti i Qarkut Dibër, me shkresën nr. 12394, datë 26.06.2019, informon problematikat e shtatë QV, të cilat janë adresuar edhe nga KZAZ nr.16, Bashkia Mat. Për të shtatë Qendrat e Votimit është kërkuar dhënie autorizimi për ndryshim të vendndodhjeve.

Kryetari i Bashkisë Mirditë, me shkresën nr. 12398, datë 26.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 824, caktuar në Qendrën Shëndetësore, e cila nuk ka siguri për zhvillimin e procesit të votimit.

Kzaz nr.42, Bashkia Kavajë, pas kryerjes së verifikimeve të ambienteve të qendrave të votimit, ka konstatuar gjendje të papërshtatshme infrastrukturore dhe mungesë e kushteve të sigurisë në dhjetë objekte ku janë caktuar vendndodhjet e dhjetë QV-ve. Në përmbushje të detyrave për administrimin e procesit në ZAZ, KZAZ nr. 42 ka kërkuar që të autorizohet ndryshimi i vendndodhjes së këtyre QV-ve duke referuar alternativat përkatëse.



Nr. 903 i Vendimit

Data 27.06.2019

Ora 16:00 e Vendimit

Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të disa QV-ve, për Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe propozimet e paraqitura, në funksion të zbatimit të rregullave dhe qetësisë së procesit zgjedhor të datës 30.06.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor nr. 14, nr. 16, nr. 42, të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

